



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina**



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), neneve 19, 22 dhe 28 të Udhëzimit administrativ (MAPL), nr. 04/2023 për administratë të hapur në komuna, nenit 32, pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 02.06.2025, merr këtë:

**V E N D I M
PËR VËNIE NË DISKUTIM PUBLIK**

1. **Miratohet** Vendimi për fillimin e procedurave të konsultimit publik për: "Strategjia e Prishtinës për artin dhe kulturën 2026-2031".
2. Organizimi i konsultimit publik do të bëhet sipas Udhëzimit administrativ (MAPL), nr. 04/2023, për administratë të hapur në komuna.
3. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, konsultimi publik zgjat jo më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 30 ditë kalendarike nga data e shpalljes së njoftimit publik për mbajtje të konsultimeve.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Kryeqytetit, respektivisht zyrtari përgjegjës për koordinimin e konsultimit publik dhe Drejtoria e Kulturës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Kryeqytetit.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-011/01-79060/25, më 04.06.2025

KRYESUES I KUVENDIT

Fehmi Kupina

